

## E DREJTA ROMAKE

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti Juridik</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>E Drejta Romake</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>Viti i parë</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3+1</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>7</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Prishtinë</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. Ass. Dr. Bedri Bahtiri</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<a href="mailto:bedri.bahtiri@uni-pr.edu">bedri.bahtiri@uni-pr.edu</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	<p><i>E drejta romake është një nga disiplinat më e lashtë juridike në Evropë. Kjo e ka karakterin e disiplinës juridiko-historike por është bazë e drejtës civile modern.</i></p> <p><i>Kjo lëndë përfshinë institucionet e Justinianit dhe të drejtën private romake në kuptimin të saj më të gjerë (përveç të drejtës pronësore përfshinë edhe njohuri bazike lidhur me të drejtën statusore dhe familjen).</i></p> <p><i>Përmes kësaj lënde synohet që të kuptohen parimet dhe mekanizmat e së drejtës romake.</i></p> <p><i>Studimi i saj përqëndrohet në krijimin e koncepteve kryesore të së drejtës civile, zhvillimin e mendimit juridik, dhe mjeteve përmes të cilave e drejta është zbatuar në jetën e përditshme.</i></p> <p><i>Për më tepër, kjo lëndë përmban edhe informata themelore lidhur me zhvillimin e shtetit romak, strukturën shoqërore dhe ekonomike, si dhe njohuri të përgjithshme lidhur me çështjet kryesore të zhvillimit të së drejtës dhe të burimeve juridike.</i></p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p><i>Kjo lëndë mësimore ka për qëllim:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>fitimi i njohurive lidhur me procesin e krijimit, evoluimit dhe ndryshimeve në institucionet dhe normat e së drejtës romake nën veprimin e rrethanave të ndryshme historike;</i></li> <li>- <i>kuptimi i vazhdueshmërisë së traditës juridike të Evropës kontinentale dhe teorisë juridike;</i></li> <li>- <i>nxjerrja e përfundimeve të përgjithshme lidhur me</i></li> </ul>

	<p><i>rolin dhe ndikimin e së drejtës në zhvillimin historik të shtetit romak;</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>njoftimi i studentëve me terminologjinë juridike e cila edhe sot është aktuale;</i></li> <li>- <i>njohja me ndikimin e së drejtës romake në të drejtën bashkëkohore të shteteve evropiane, e cila është ndërtuar mbi konceptet dhe normat e së drejtës romake, nëpërmjet pranimet të drejtpërdrejtë ose përmes teorisë baza e së cilës u zhvillua nga mësimi i së drejtës romake nëpër universitete;</i></li> <li>- <i>njohja me teknikat e punës së juristëve romak, të cilat paraqesin model me vlera të përhershme kur është fjala për funksionimin praktik të së drejtës dhe përshtatjes së saj nevojave shoqërore.</i></li> </ul>		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p><i>Të kuptuarit e Drejtës Romake dhe ndikimi i saj në Drejtën moderne civile</i></p> <p><i>Njohuri mbi parimet më themelore të së Drejtës Romake</i></p> <p><i>Aftësimi për të prezantuar në publikë</i></p>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	<b>3</b>	<b>1/15</b>	<b>45</b>
Ushtrime teorike/laboratorike	1	1/15	15
Punë praktike	1	1/15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1/15	15
Ushtrime në teren	4	1/4	16
Kollokfiime, seminare	2	2/2	4
Detyra të shtëpisë	2	1/13	26
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	1/15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	1/15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	4	1/1	4
Projektet, prezantimet ,etj	10	1/1	10
<b>Totali</b>	<b>7 ECTS</b>	<b>Total</b>	<b>210</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p><i>Ligjërata interaktive, me ç 'rast do të përfshihen edhe studentët në mënyrë që të zhvillohet logjika juridike, argumentimi dhe prezantimi.</i></p>		

	<p><i>Përgatitja e punimeve seminarike dhe prezantimi i tyre si dhe mbrojtja e punimit seminarik gjatë debatit me kolegët e tyre.</i></p> <p><i>Analiza lidhur me ligjet aktuale dhe parimet të së Drejtës Romake që janë të mishëruar në ato Ligje</i></p>
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. rregullsia dhe aktiviteti në ligjërata, vlerësohet prej 0-10 pikë;</li> <li>2. prezantimi i punimit seminarik, vlerësohet prej 0-10 pikë;</li> <li>3. kollokuimi vlerësohet prej 0-30 pikë;</li> <li>4. provimi përfundimtar vlerësohet prej 0-50 pikë.</li> </ol>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<p><i>Asllan Bilalli &amp; Bedri Bahtiri, E drejta Romake, Prishtinë 2015</i></p> <p><i>Asllan Bilalli, Fjalor Spjegimor latinisht-shqip, Prishtinë 2015</i></p>
<b>Literatura shtesë:</b>	<p><i>Ivo Puhan, E drejta romake, Prishtinë, 1988.</i></p> <p><i>Ivo Puhan &amp; Mirjana Polenak - Akimovska, Rimsko pravo, Skopje, 1996.</i></p> <p><i>Arta Mandro, E drejta romake, Tiranë, 1998</i></p> <p><i>Barry Nicholas, An Introduction to Roman Law, Oxford, 1975</i></p> <p><i>Andrew Borkowski &amp; Paul du Plessis, Textbook on Roman Law, Oxford, 2005.</i></p> <p><i>HF Jolowicz &amp; Barry Nicholas, A Historical Introduction to the Study of Roman Law, 3rd ed., Cambridge, 2008.</i></p> <p><i>Marijan Horvat, Rimsko pravo, Zagreb, 2007.</i></p> <p><i>Ante Romac, Rimsko pravo, Zagreb, 2007.</i></p> <p><i>Ante Romac, Izvori rimskog prava, Zagreb, 1973</i></p>
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	<b>Studentët do të njoftohen me përmbajtjen e lëndës në përgjithësi, mënyrën e zhvillimit të mësimit gjatë semestrit</b>

	<p>dhe literaturën.</p> <p>Vështrim i përgjithshëm i shtetit dhe të drejtës romake. Rëndësia dhe ndikimi i së drejtës romake. Periodizimi dhe ndarja e së drejtës private romake. Burimet e së drejtës romake: Periudha e së drejtës së lashtë, klasike dhe postklasike.</p>
<i>Java e dytë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Subjektet e së drejtës.</li> <li>- Zotësia juridike dhe zotësia e veprimit.</li> <li>- Fitimi, përmbajtja, kufizimi dhe humbja e zotësisë juridike.</li> <li>- Zotësia e veprimit të personave fizik.</li> <li>- Personat juridik.</li> </ul>
<i>Java e tretë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Familja romake, pozita juridike e anëtarëve të familjes.</li> <li>- E drejta martesore: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kushtet për lidhjen e martesës.</li> <li>- Pengesat për lidhjen e martesës,</li> <li>- Fejesa,</li> <li>- Format për lidhjen e martesës,</li> <li>- Marrëdhëniet personale dhe pronësore mes bashkëshortëve,</li> <li>- Zgjidhja e martesës,</li> <li>- Tutoria dhe kujdestaria,</li> <li>- Llojet e tutorisë dhe kujdestarisë.</li> </ul> </li> </ul>
<i>Java e katërt:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kuptimi dhe krijimi i procedurës civile.</li> <li>- Procedura Legis actio, Organet e Procedurës legis actio. Procedura in iure dhe apud iudicem.</li> <li>- Aktgjykimi, anulimi i aktgjykimit, Ekzekutimi i aktgjykimit.</li> <li>- Mjetet e jashtëzakonshme për mbrojtjen e të drejtave subjektive, Interdiktet.</li> <li>- Procedura Ekstraordinare.</li> </ul>
<i>Java e pestë:</i>	Provimi i ndërmjetëm (kollokviumi i parë)
<i>Java e gjashtë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nocioni i sendeve.</li> <li>- Marrëdhëniet sendore-juridike.</li> <li>- Llojet e sendeve.</li> <li>- Posedimi.</li> <li>- Mbrojtja e posedimit.</li> <li>- Kuptimi i pronës private dhe përmbajtja e saj.</li> <li>- Kufizimet.</li> <li>- Llojet e pronës private.</li> </ul>
<i>Java e shtatë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Fitimi i pronësisë.</li> <li>- Mënyrat e fitimit të pronësisë.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mjetet juridike për mbrojtjen e pronësisë.</li> <li>- Humbja e pronësisë.</li> </ul>
<i>Java e tetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të drejtat sendore mbi sendet e huaja.</li> <li>- Servituti.</li> <li>- Pengu.</li> </ul>
<i>Java e nëntë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Marrëdhëniet e detyrimeve.</li> <li>- Subjektet e marrëdhënieve të detyrimeve.</li> <li>- Përfaqësimi.</li> <li>- Ndërrimi i subjekteve.</li> </ul>
<i>Java e dhjetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përbajtja e detyrimeve, elementet esenciale.</li> <li>- Elementet jo esenciale.</li> <li>- Sigurimi i aktiveve.</li> <li>- Sigurimi real dhe ai personal.</li> <li>- Shuarja e detyrimeve.</li> <li>- Përbushja e detyrimeve dhe pasojat e mos përbushjes së detyrimeve.</li> </ul>
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kontrata si burim detyrimesh, kuptimi dhe klasifikimi i kontratave.</li> <li>- Kontratat reale dhe konsensuale: <ul style="list-style-type: none"> <li>- huaja,</li> <li>- huapërdorja,</li> <li>- depozita,</li> <li>- pengu,</li> <li>- shitblerja,</li> <li>- qiraja,</li> <li>- kontrata në vepër.</li> </ul> </li> </ul>
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Deliktet si burime detyrimesh.</li> <li>- Detyrimet të cilat krijohen nga bazat tjera të ndryshme.</li> </ul>
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Marrëdhëniet trashëgimore-juridike.</li> <li>- Mënyrat e thirrjes në trashëgim.</li> <li>- E drejta e domosdoshme e trashëgimit.</li> <li>- Fitimi i trashëgimit.</li> <li>- Testamenti.</li> </ul>
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Provimi i ndërmjetëm (kollokviumi i dytë)
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Provimi Përfundimtarë

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
<i>Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UP-së.</i>
<i>Studentët janë të obliguar që të vijojnë ligjëratat, ushtrimet si dhe të gjitha aktivitetet gjatë gjithë semestrit.</i>